9026

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR.............Aktit.

9026

VENDIM

"PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK"

Sot,me date                ne Gjykaten e rrethit Tirane, une Gjygjtarja e kesaj gjykate,pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Gezim Salla per te regjistruar shoqerine si person juridik:

KONSTATOVA

Se,kerkesa e Gezim Salla per te njohur si person juridik shoqerine e themeluar prej tij te emeruar "SALLA"sh.p.k. Import-Eksport,ne aktivitetin: tregtim te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore,produkte bujqesore e blegtorale fruta-perime,plehra kimike me shumice e pakice.Import-Ekspor prodhim e tregtim pije freskuese e alkolike me shumice epakice; prodhim,perpunim e tregtim materiale inerte; TRANSPORT mallrash.Shoqeria e ka seline ne fshatin Shtermen,Elbasan. Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke,duke qene ortak i vetem dhe me nje aktivitet mbi dhjete vjet. Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si etille dunet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjes 7638 date 19/XI/1992"Per Shoqerite Tregtare".

VENDOSA

Regjistrimin e shoqerise "SALLA"sh.p.k.Import-Eksport, si person juridik te themeluar nga ortaku i vetem Gezim Salla ne aktivitetin; tregtim te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore,produkte bujqesore e blegtorale,fruta-perime, plehra kimike me shumice e pakice.Import-Eksport; prodhim e tregtim pije freskuese e alkolike me shumice e pakice; prodhim,perpunim e tregtim materiale inerte; transport mallra. Shoqeria e ka seline e saj ne fshatin Shtermen,Elbasan. Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe aktiviteti i saj mbi dhjete vjet dhe me ortak te vetem Gezim Salla

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYGJTARE

## STATUTI I SHOQERISE

## "SALLA"sh.p.k.IMPORT-EKSPORT

(ORTAK I VETEM)

### FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare me emertim "SALLA"me pergjegjesi te kufizuar,e themeluar nga ortaku i vetem z.Gezim Salla, i biri Ramazanit,dat.1959,banues ne fshatin Shtermen,Elbasan

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne fshatin Shtermen terrethit te Elbasanit.Shoqeria mund te hape edhe vend qendrime te tjera te dyta,operative,filjale,perfaqsi ne te gjithe terirorën e vendit.

### KOHE ZGJATJA

NENI 3

Koha e zgjatjes veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10(dhjete)vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Veprimtaria tregtare e shoqerise eshte sa vijon:
- Tregtim te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore, produkte bujqesore e blegtorale,fruta-perime,plehra kimike me shumice e pakice.Import-Eksport.
- Prodhim e tregtim pije freskuese e alkolike me shumice e pakice.
- Prodhim,perpunim e tregtim materiale inerte.
- Transport mallrash.

Si dhe çdo aktivitet tjeter veças ose se bashku me ato te permendura me siper qe do te ndikojne ne zhvillimin dhe rritjen e veprimtarise se shoqerise.

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emrin,seline si dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre pronari i saj.

### KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke,i formuar ne masen e ploete nga ortaku i vetem.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te paksohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem.

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 8

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te ploet te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi.Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne Gjykaten e Tiranes dhe ndersa

ushtron aktivitetin tregtar me regjistrimin ne Zyren e Tatimeve.

NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen Shoqeria Tregtare "SALLA"sh.p.k.Import-Eksport.

NENI 10

Shoqeria tregtare vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detryimet.Ajo pergjigjet vetee per detryimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj.Ortaku i vetem mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

NENI 11

Shoqeria eshte prone e themeluesit te saj.Ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti,te cilat jane te detyrueshem per tu zbatuar nga te gjithe punonjesit ne kete shoqeri.

NENI 12

Ortaku i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise,emeron Administrator si dhe puneson punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike te permendura ne nenin kater te ketij statuti.

NENI 13

Ortaku i vetem i shoqerise dhe Administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi.Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise Ata kane te drejte midis te tjerash te blejne e te kembejne pasuri,te lidhen me shoqeri te tjera te vendit ose te huaja, te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave private apo shtetrore qe kane te bejne me garancite,ipotekat.Te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi,kreditimi,pagesa,arketime.Ne keto raste Administratori i ngarkuar ka per detyre te njoftoje dhe ti jape llogari ortakut te vetem.

NENI 14

Perfaqsimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe Administratorit te ngarkuar.Ata kane te drejten e perfaqsimit te shoqerise ne organet gjygjsore e administrative,te caktoj e te pushoje avokat per çdo problem.

<u>BILANCI DHE TE ARDHURAT</u>

NENI 15

Veprimet ekonomike-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te çdo viti.Ne fund te çdo periudhe ushtrimore, Administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me llogarine FITIM-HUMBJE,mbeshtetur ne ligje dhe rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private percaktuar nga organet kopetente te sistemit fiskal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem,i cili

vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garancine e veprimtarise se shoqerise,fondin e akumulimit,fondin rezerve etj.

NENI 16

Te ardhurat neto pas veçimit te fondeve ligjore te permendura me siper dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale,nga fitimi i mbesin per perdorim ortakut te vetem.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 17

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe perçfardo shkaku si humbja e kapitalit,pamundesi veprimtarie. Ne keto raste ortaku i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore.Keta bejne kujdes qe shoqeria te likjdoje me pare detyrimet qe ajo ju ka personave te trete fizike e juridike.

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

NENI 18

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut,i referohet plotesimeve nga ortaku i vetem dhe ligjeve perkatse shqiptare.

NENI 19

Ky statut perpilohej ne kater kopje per tju shperndare organeve kopetente,ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

ORTAKU I VETEM
(GEZIM SALLA)

NOTERIA ELBASAN
NR...250.......

Elbasan,14.2.1995

VERTETIM

Sot,me date 14.2.1995,ne zyren e noterise dhe perpara meje noteres,u paraqit personalisht Gezim Salla,i biri i Ramazanit,banues ne fshatin Shtermen,Elbasan,madhore dhei afte per te kryer veprime juridike,shtetsia shqiptare,i cili mu be i njohur ne baze te leter-njoftimit qe me paraqiti dhe me deklaroi se sa me siper eshte shkruajtur konform vull netit te tij te lire.Nenshkrimi i tij u vertetua nga une noterja.

NOTERE
MAJLINDA LATO

PULLE TAKSE

## AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

## "SALLA" sh.p.k.IMPORT-EKSPORT

Sot,me date 14.2.1995,une i quajturi Gezim Salla,i bir i Ramazanit,dat.1959,lindur e banues ne fshatin Shtermen, Elbasan,themeloj shoqerine me pergjegjsi te kufizuar si ortak i vetem.

NENI 1

Shoqeria emertohet "SALLA" sh.p.k.Import-Eksport.

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne fshatin Shtermen,Elbasan.

NENI 3

Shoqeria ka nje aktivitet te saj mbi dhjete vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe.

NENI 4

Shoqeria ka per aktivitet te saj:

- Tregtim te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore, produkte bujqesore e blegtorale,fruta-perime,plehra kimike me shumice e pakice.Import-Eksport.
- Prodhim e tregtim pije freskuese e alkolike me shumice e pakice.
- Prodhim,perpunim e tregtim materiale inerte.
- Transport mallrash.

NENI 5

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke.

ORTAKU I VETEM
(GEZIM SALLA)

NOTERIA ELBASAN
NR....250.......

Elbasan,14.2.1995

V E R T E T I M

Sot,me date 14.2.1995,ne zyren e noterise dhe perpara meje noteres,u paraqit personalisht Gezim Salla,i biri i Ramazanit,banues ne fshatin Shtermen,Elbasan,madhore dhe i afte per te kryer veprime juridike,shtetsia shqiptare,i cili mu be i njohur ne baze te leter-njoftimit qe me paraqiti dhe me deklaroi se sa me siper eshte shkruajtur konform vullnetit te tij te lire.Nenshkrimi i tij u vertetua nga une noterja.

N O T E R E
MAJLINDA LATO

PULLE TAKSE

9026

K E R K E S E

E

GEZIM SALLA

i biri Ramazanit, lindur me 1959, banues ne fshati Shtermen, Elbasan.

OBJEKTI

Kerkoj regjistrimin e shoqerise si person juridik.

---

GJYKATES SE RRETHIT T I R A N E

Mbi kerkesen time, kerkoj te njohim si person juridik shoqerine "SALLA"sh.p.k.Import-Eksport, te themeluar prej meje si ortak i vetem i kesaj shoqerie ne aktivitetin: tregtim te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore, produkte bujqesore e blegtorale, fruta-perime, plehra kimike me shumice e pakice.Import-Eksport; prodhim e tregtim pije freskuese e alkolike me shumice e pakice; prodhim, perpunim, tregtim materiale inerte; transport mallrash.Shoqeria eka seline e saj ne fshatin Shtermen, Elbasan.Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke, me nje aktivitet mbi dhjete vjet dhe me ortak te vetem Gezim Salla.

Sa siper kerkoj regjistrimin e shoqerise.

K E R K U E S I
(GEZIM SALLA)

Te regjistrohet
dt. 20-2-95

NOTERIA ELBASAN
NR...250.....

Elbasan, 14.2.1995

V E R T E T I M

Sot, me date 14.2.1995, ne zyren e noterise dhe perpara meje noteres, u paraqit personalisht Gezim Salla, i biri i Ramazanit, banues ne fshatin Shtermen, Elbasan, madhore dhe i afte per te kryer veprime juridike, shtetsia shqiptare, i cili mu be i njohur ne baze te leter-njoftimit qe me paraqiti dhe me deklaroi se sa me siper eshte shkruajtur konform vullnetit te tij te lire.Nenshkrimi i tij u vertetua nga une noterja.

N O T E R E
MAJLINDA LATO